

## Shenimet shpjeguese per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 dhjetor 2021

### 1. NATYRA E AKTIVITETIT DHE KUADRI KONTABËL I APLIKUAR

#### 1.1 AKTIVITETI:

Shoeria Everest shpk eshte e rregjistruar ne Drejtorene Rajonale Tatimore te Tatimpaguesve te Medhenj, me N.I.P.T J78311921L. Objekti i veprimitarise "Prodhim e tregtim profile alumini dhe aktivitete ndertimi, import-eksport". Veprimitari ne sektorin e perpunimit aktiv etj.

Forma juridike Sh.p.keshte regjistruar ne organet tatimore me Numri i Vendimit:17484, Gjykata Tirane dt. 28/07/1999 me Administrator te shoqerise Z.Sokol Cupi dhe aksioner te shoqerise Z.Ilir Cupi me 25% te aksioneve, Hyqmet Valterime 12.5% te aksioneve, Esat Valteri me 12.5% te aksioneve, Albert Valteri me 12.5% te aksioneven, Kujtim Valteri me 12.5% te aksioneve, dhe Sokol Cupi me 25% te aksioneve, me qender ne Tirane, Kamez, Fabrika ne Rrugen Nacionale, Prane Nyjes se Betonit.

Kapitali i nenshkruar i shoqerise eshte 450.000.000. leke, e regjistruar ne Q.K.R.

Adresa e selise: "Fabrika ne Rrugen Nacionale, Prane Nyjes se Betonit", Kamëz ku ndodhet fabrika e prodhimit të profileve të aluminit e plastike, magazinat dhe zyra qëndrore te shoqërisë, dhe në këtë adresë shoqëria kryen aktivitet shitje mallra me shumicë. Kjo adresë është pronë e shoqërisë me certifikat pronësie.

Gjate vitit 2021 shoqeria ka implementuar dhe zbatuar ndryshimet e politikave fiskale ne fushen e Prodhim e tregtim profile alumini dhe aktivitete ndertimi, import-eksportne perputhje me Legjislacionin fiskal ne fuqi.

### 2. BAZA E PERGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE

#### 2.1 Bazat e pergatitjes

Pasqyrat financiare te shoqerise jane pergatitur ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF). Kontabiliteti mbahet ne menyre te informatizuar.

Regjistrimet kontabel jane te bazuara ne dokumentacionin baze, i cili eshte i autorizuar dhe i aprovuar nga personat e ngarkuar, me autoritetin qe kane ne perputhje me rregullin e brendshem.

#### 2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare te Shoqerise jane pergatitur mbi bazen e kostos historike, me perjashtim te rasteve nese percaktohet ndryshe.

#### 2.3 Monedha funksionale dhe me te cilen paraqiten pasqyrat

Pasqyrat Financiare paraqiten ne monedhen vendase Lek (ALL), e cila eshte monedha funksionale dhe raportuese e Shoqerise.

#### 2.4 Konvertimi i monedhave te huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates ne te cilin eshte kryer transaksi. Aktivet dhe pasivet monetare ne monedhe te huaj ne daten e mbylljes se bilancit jane rivleresuar ne monedhen funksionale sipas kursit te shpallur nga Banka e Shqiperise ne daten e mbylljes se periudhes ushtrimore. Diferencat qe rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare te kembimit per monedhat kryesore te perdonura ne konvertimin e gjendjeve te bilancit emertuar ne monedhe ne huaj ne daten e hartimit te bilancit jane si me poshte (ne LEK):

Shenimet shpjeguese per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 dhjetor 2021		
Monedha	31.12.2021	31.12.2020
EUR	120,76	123,7
USD	106,54	100,84

## 2.5 Instrumentat Financiare

Shoqëria mban vetëm instrumente financiare jo-derivativ që përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera, mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, huatë dhe llogari të pagueshme dhe të tjera. Instrumentat financiar jo-derivativ njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat jo në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, duke i shtuar çdo kosto që lidhet drejtpërdrejtë me transaksionin. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiar jo-derivativ maten si më poshtë. Një aktiv finanziar njihet nëse Shoqëria bëhet pjesë në kushtet kontraktuale të aktivit. Shoqëria c'regjistron një aktiv finanziar kur të drejtat kontraktuale mbi rrjedhjen e mjeteve monetare nga aktivitet financiare skadojnë ose në qoftë se ajo transferon të drejtat për të arkëtuar rrjedhjen e mjeteve monetare kontraktuale të aktivitet financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivitet financiar transferohen. Blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare regjistrohen në datën e tregtimit, p.sh. data në të cilën Shoqëria angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivit. Detyrimet financiare c'regjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuara në kontratë skadojnë ose janë hequr ose anulluar.

### Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe garancitë e vendosura në bankat tregtare vendase. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

### Llogari të arkëtueshme dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.

Provigioni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme krijohet kur ka tregues objektiv që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve origjinale të llogarive të arkëtueshme.

Vështirësítë e konsiderueshme financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose të ndodhë një riorganizim financiar dhe mospagesa konsiderohen indikatorë që llogaritë e arkëtueshme janë zhvlerësuar.

Shuma e provigionit është diferenca midis vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të rrjedhjes së ardhshme të mjeteve monetare, të skontuara me normën e interesit efektiv. Aktivet me maturitet afatshkurtër nuk skontohen. Vlera kontabël e aktivit zgjelohet përmes përdorimit të një llogarie provigioni dhe shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje. Kur një llogari e arkëtueshme është e pambledhshme, vlera në bilanc mbylllet kundrejt një provigioni për këtë llogari. Nëse shumat rikuperohen më vonë, ato regjistrohen në fitmi ose humbje.

### Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe në vazhdimësi maten me koston e amortizuar.

### Njohja e zhvlerësimit të aktiveve financiare

Një aktiv finanziar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka tregues objektiv që tregon se një ose disa ngjarje kanë patur një ndikim negativ në rrjedhjen e ardhshme të mjeteve monetare të vlerësuara të aktivitet financiar.

Një zhvlerësim në vlerë në lidhje me një aktiv finanziar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferençë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të rrjedhjes së ardhshme të mjeteve të parasë të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale të interesit efektiv të aktivit.

Aktivet financiare individualisht të rendësishme testohen për zhvlerësim mbi bazë individuale. Aktivet e mbetur financiare vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Një humbje nga zhvlerësimi anullohet nëse kthimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi zhvlerësimi është njojur. Rimarrja njihet në fitim dhe humbje.

### Kompensimi i instrumentave financiare

Aktivet financiare dhe detyrimet financiare netohen dhe vlera neto njihet në pasqyrën e pozicionit financiar nëse ekziston një e drejtë ligjore e ekzekutueshme për të netuar shumat e njoitura dhe ka një qëllim për shlyerje mbi balancën neto për të përfituar aktivin dhe për të shlyer detyrimin njëkohësisht.

## 2.6 Afatgjat Materiale

### (i) Njohja dhe matja (vazhdim)

## Shenimet shpjeguese per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 dhjetor 2021

Programet kompjuterike të blera, të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të pajisjes përkatëse, kapitalizohen si pjesë e saj. Kur pjesë të një elementi të aktiveve të trupëzuara kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve të trupëzuara.

Të ardhurat dhe humbjet nga shitja e një aktivi të trupëzuar përcaktohen duke krahasuar të hyrat nga shitja e aktivit me vlerën kontabël të tij dhe njihen me vlerë neto tek “të ardhura të tjera”/” shpenzime të përgjithshme dhe administrative” në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (në fitim ose humbje).

### (ii) Kostot vijuese

Nëse është e mundshme që përfitime ekonomike që i atribuohen një elementi të aktiveve të trupëzuara do të rrjedhin në të ardhmen në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet në mënyrë të besueshme, kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve të trupëzuara njihet me vlerën kontabël të elementit. Vlera e mbetur e aktiveve të zëvendësuara çregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve të trupëzuara njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) në momentin kur ato ndodhin.

### (iii) Amortizimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) dhe llogaritet me metodën lineare sipas jetëgjatësisë së çdo pjese apo njësie të aktiveve të trupëzuara. Aktivet e marra me qira zhvlerësohen sipas më të voglës midis jetëgjatësisë së aktivit dhe kohës së huasë, përveçse kur që është e qartë se Shoqëria do të fitojë pronësinë në përfundim të kontratës së qirasë. Toka nuk zhvlerësohet.

Normat e zhvlerësimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuese janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndertesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri e paisje	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	25%
Pajisje kompjuterike	Vlera e mbetur	25%

Metodat e amortizimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur e aktiveve të trupëzuara rishikohen në çdo datë raportimi.

## 2.7 Aktivet e afatgjata jo material

Aktivet afatgjata jo materiale perfshijnë licencat, programet, websit-et dhe te drejtat per perdomim.

### (i) Njohja dhe matja

Aktivet e patrupezuara paraqiten me kosto minus amotizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi.

### (ii) Kostot vijuese

Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetem ne rastin kur shtojne përfitimet e ardhshme ekonomike te trupëzuara ne aktivin specifik me te cilat ato lidhen. Te gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje ne momentin kur kryhen.

### (iii) Amortizimi

Amortizimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve duke perdonur metoden lineare mbi jetegjatesine e parashikuar te aktiveve te patrupezuara qe nga data qe jane te disponueshme per perdomim. Ne vecanti amortizimi per programet, jane llogaritur me normen fiskale 25%.

## 2.8 Inventaret

Inventarët mbahen me vlerën më të voglës midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarëve bazohen në metodën “hyrja e parë, dalja e parë” dhe përfshin shpenzimet që ndodhin në blerjen e tyre, prodhimin ose këmbimin dhe kosto të tjera për t'i sjellë ato në kushtet dhe vendndodhjen

ekzistuese. Kosto përfshin edhe një pjesë të përshtatshme të kostove operacionale bazuar në kapacitetin normal operacional.

Vlera neto e realizueshme është çmimi i parashikuar i shitjes në aktivitetin normal të biznesit duke hequr kostot e përfundimit dhe shpenzimet e shitje.

## 2.9 Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase (mjetet monetare) perfshijnë tepricat e arkes, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne bankat. Per qellime te pasqyres se fluksit te parase, paraja dhe ekuivalentet te saj perfshijnë depozita pa afat dhe ato me nje maturim prej

Shenimet shpjeguese per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 dhjetor 2021

tre muajsh ose me pak qe nga data fillestare. Likuiditetet dhe vlera arke te tjera maten me tej me koston e amortizuar pakesuar me humbjet nga zhvleresimet.

## 2.10 Llogari të arkëtueshme

Llogarite e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Llogarite e arketueshme afatshkurtra nuk skontohen

Provizoni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Shuma e provzionit llogaritet si difference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit. Shoqëria e quan një aktiv financiar në vështirësi për t'u arkëtar në rastet kur pagesat kontraktuale janë me pak se 30 - 90 ditë me vonesë. Megjithatë, në disa raste, Shoqëria mundet gjithashtu që ta konsiderojë një aktiv financiar në vonesë pagesë, atëherë kur informacioni i brendshëm ose i jashtëm tregon qe Shoqëria ka pak mundësi të arkëtojë të plota shumat e mabetura kontraktuale para se të konsiderojë metodat e uljes së riskut të kredisë. Një aktiv financiar hiqet nga librat kontabël kur nuk ka asnje tregues të arsyeshëm që flukset kontraktuale të parashë do të arkëtohen.

Kerkesat per arketim vleresohen me vleren nominale minus humbjen nga zhvleresimi. Ato nuk jane vleresuar me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv per te llogaritur vleren e interesit te paperfituar ne pasqyrat financiare perderisa nuk ka efekte materiale te ketyre interesave ne daten e mbylljes se bilancit.

## 2.11 Llogari të pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv nese eshte materiale.

## 2.12 Hua të marra dhe të dhena

Huate e marra dhe te dhena njihen fillimisht me vleren e drejte, pa perfshire koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huate e marra dhe te dhena paraqiten me kosto te amortizuar duke njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve çdo difference midis kostos dhe vleres se pagueshme nominale per gjate periudhes se huamarrjes duke u bazuar ne interesin efektiv.

Fitimet dhe humbjet njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivet dhe detyrimet financiare te mesiperme zhvleresohen sikurse dhe nepernjet procesit te amortizimit.

## 2.13 Të tjera

Instrumenta te tjere jo-derivative maten me kosto te amortizuar sipas metodes se interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvleresimi.

## 2.14 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vleren nominale

## 2.15 Provizonet

Nje provizion njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar, shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkoje flukse dalese parash per shlyerjen e tij.

Provizonet percaktohen duke skontuar (nese eshte materiale) flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme skontimi para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimin ne fjale. Provizonet rishikohen ne çdo date bilanci dhe nese nuk ka me gjasa per daljen e ndonje fluksi parash per shlyerjen e detyrimit, provizonet kthehen. Provizonet perdoren vetem per qellimin qe jane njohur fillimisht. Ato nuk njihen per humbjet e ardhshme operative. Aktivet e kushtezuara nuk njihen por paraqiten ne shenime kur jane sinifikative.

## 2.16 Të ardhurat - Njohja

Te ardhurat nga Sherbimet

Te ardhurat nga sherbimet regjistrohen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne proporcione perfundimin e sherbimit ne daten e raportimit. Te ardhurat qe lidhen me aktivitetin kryesor jane te pasqyruara ne kohen e perfitimit te tyre.

Te ardhura nga shitja

Te ardhurat nga shitja njihen plotesisht ne momentin e dorezimit kur kryhet shitja dhe/ose sherbimi.

## 2.17 Shpenzimet

Te gjitha shpenzimet njihen si te tilla kryesisht me marrjen e fatures perkatese dhe perfshihen ne shpenzimet per shitjen, te per gjithshme dhe ato administrative ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

## 2.18 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marre parasysh metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet per interesa perfshijne interesin e pagueshem mbi borxhet e marra per qellime te kapitalit te punes, te perllogaritur me metoden e normes efektive te interesit.

## 2.19 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi apo humbjet e vitit perbehet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve perveç rasteve kur lidhet me zera qe njihen direkt ne kapital, rast ne te cilin edhe tatimi njihet ne kapital. Tatimi aktual eshte tatimi i pritur per t'u paguar mbi fitimin e tatushem te vitit, duke aplikuar normat tatimore ne fuqi ne daten e bilancit, si edhe çfarendolloj rregullimi kontabel te tatimit per t'u paguar ne lidhje me vitet e meparshme. Norma e tatimit mbi fitimin per vitin 2021 eshte 15% (2020; 15%)

## 2.20 Fondet për pensione

Shoqeria paguan ne emer te saj dhe te punonjesve kontributet per pensione si edhe kontribute per sigurim shendetesor per punonjesit e saj sic eshte parashikuar nga legjislacioni ne fuqi. Kontributet e llogaritura ne emer te Shoqerise ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne momentin qe ato ndodhin.

## 2.21 Ngjarje pas datës së bilancit

Ngjarjet pas bilancit qe nuk jane ngjarje rregulluese paraqiten te shpalosura ne shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare kur jane materiale nese ka ngjarje.

# 3. STANDARDET E REJA DHE AMENDIMET

## 3.1 Standarde të publikuara që janë të aplikueshme

Shoqëria ka aplikuar amendime dhe interpretime të aplikueshme për herë të parë në vitin 2021, por nuk kanë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë, duke perfshire dhe amendimit e IAS 1, i cili eshte perhkruar me detaje te metejshme si me poshtë.

### SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet: Përkufizimi i 'materialit' (Ndryshimet)

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2021 me leje zbatimi më të hershme. Ndryshimet sqarojnë përkufizimin e materialit dhe mënyrën se si duhet të zbatohet. Në përkufizimin e ri thuhet se, 'Informacioni është material nese heqja, keqdeklarimi ose errësimi, mund të pritet që të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të qëllimit të përgjithshëm bëjnë në bazë të atyre pasqyrave financiare, të cilat ofrojnë informacion finansiar për një raport specifik entiteti.'

Drejtimi ka bërë një vlerësim të efektit të standardit dhe konsideron që standardi i ri nuk ka efekt në pasqyrat financiare të kompanisë.

Standardet, ndryshimet dhe përmirësimet e reja në vijim janë bërë efektive në 1 Janar 2021 megjithatë nuk janë të zbatueshme për Kompaninë.

- Ndryshimet në SNRF 3: Kombinimet e Biznesit,

- Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7: Reforma e Vlerësimit të Normës së Interesit,

- Ndryshimet në Kornizën Konceptuale të SNRF-ve

Shenimet shpjeguese per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 dhjetor 2021

### **3.2 Standarde dhe interpretime te publikuara qe nuk jane ende te aplikueshme**

Disa standarde të reja janë efektive për periudhat që fillojnë pas datës 1 janar 2021 dhe zbatimi i hershëm është i lejuar, megjithate nuk janë adoptuar në mënyrë të hershme nga Shoqëria në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare dhe nuk pritet të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën e aplikimit fillestar dhe jane si më poshtë:

- Kontratat me Kushte Rënduese-Kostot e përbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37);
- Tatimi i Shtyrë në lidhje me Aktivet dhe Detyrimet e krijuara nga transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 12);
- Koncesion i qirasë në lidhje me Covid 19 për periudhat raportuese vjetore që fillojnë pas 30 qershorit 2022 (Ndryshimet ne SNRF 16);
- Përmirësimet Vjetore në Standartet SNRF 2018-2020;
- Pasuritë, Impiantet dhe Pajisjet: Shumat e marra para përdorimin e tij të synuar (Ndryshimet në SNK 16);  
Referencia në Kuadrin Konceptual (Ndryshimet në SNRF 3);
- Klasifikimi i Detyrimeve si afatshkurtër apo afatgjatë (Ndryshimet në SNK 1);  
SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve dhe ndryshimet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve;
- Shpalosjen e Politikave Kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklaratën e Praktikës 2 të SNRFsë);
- dhe Përcaktimin e Çmuarjeve Kontabël (Ndryshimet në SNK 8)

## **4. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE**

### **4.1 Investime finANCIARE AFATGJATA**

Gjendja e AAF-re si dhe investimet tyre gjatë vitit ushtrimor paraqiten ne vleren 1,242,383,552 leke, te cilat kane lidhje me investimet ne Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata ne vlere 1,242,383,552 leke. Gjate vitit vlera e tyre eshte shtuar ne shumen 239,257,030 leke.

### **4.2 Aktivet Afatgjata Materiale**

Gjendja e aktiveve afatgjata materiale me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2021, paraqitet si më poshtë:

AAM	Ndertesa Toka	Makineri	Mjete transporti	Paisje informatike	Mobilje zyre	Te tjera	Totali
Në janar 2021	301,538,298	742,790,158	111,899,370	13,191,112	3,256,677	66,701,167	1,239,376,782
Shtesa		165,357,585	73,341,235	717,630			239,416,450
Pakesime		510,735					510,735
<b>Në 31 Dhjetor 2021</b>	<b>301,538,298</b>	<b>907,637,008</b>	<b>185,240,605</b>	<b>13,908,742</b>	<b>3,256,677</b>	<b>66,701,167</b>	<b>1,478,282,497</b>
<b>Amortizimi i akumuluar:</b>							
Në 1 Janar 2021	38,732,880	298,790,044	76,108,237	6,581,958	1,499,555	55,832,300	477,544,974
Amortizimi i vitit	8,048,961	109,340,313	17,692,160	1,746,741	351,424	1,890,878	139,070,477
Pakesime							
<b>Në 31 Dhjetor 2021</b>	<b>46,781,841</b>	<b>408,130,357</b>	<b>93,800,397</b>	<b>8,328,699</b>	<b>1,850,979</b>	<b>57,723,178</b>	<b>616,615,451</b>
<b>Vlera kontabile neto:</b>							
Në 31 Dhjetor 2020	262,805,418	444,000,114	35,791,133	6,609,154	1,757,122	10,868,867	761,831,808
Në 31 Dhjetor 2021	254,756,457	499,506,651	91,440,208	5,580,043	1,405,698	8,977,989	861,667,047

## Shenimet shpjeguese per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 dhjetor 2021

Normat e amortizimit te perdonura, jane te njejtë me normat fiskale ne fuqi.

### 5. INVENTARE

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Lende e pare materiale kryesore	265,427,594	215,383,529
Mallra	39,808,382	24,339,238
	<b>305,235,976</b>	<b>239,722,767</b>

Inventari i mallrave gjendje ne 31 Dhjetor 2021, perbehet kryesisht nga produkt alumin per shitje ne vleren 39,808,382 leke dhe aksesore prodhimi ne vlore 265,427,594 leke.

### 6. AKTIVE TE TJERA AFAT SHKURTERA

Aktive te tjera afatshkurtra analizohet sipas zerave ne tabelen e meposhteme:

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Kliente	1,431,911,096	774,437,875
Kerkesa te tjera te arketueshme tatime tvsh		
Aktive te tjere financiare afatshkurter (Tatim Fitimi)		
Hua te tjera financiare	<b>1,431,911,096</b>	<b>774,437,875</b>

#### 6.1 Paradhenie per furnizime

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Paradhenie per furnitoret	54,748,707	150,390,129
	<b>54,748,707</b>	<b>150,390,129</b>

Parapagime dhe shpenzimet e shtyra nuk ka ne fund te vitit.

### 7. AKTIVET MONETARE

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Banka	190,226,251	234,376,414
Arka		
	<b>190,226,251</b>	<b>234,376,414</b>

Shoqeria ka llogari rrjedhese prane Procredit Bank ne All, Euro, Usd dhe bankat e tjera te nivelit te dyte.

### 8. KAPITALI I AKSIONAR

Ne vitin 2021, kapitali i nenshkruar i shoqerise eshte 450,000,000 leke. Regjistrimi i kapitalit eshte bere ne perputhje me Ligjin "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", sipas vendimit teasamblese se per gjithshme te ortakeve dhe eshte depozituar prane QKB.

## Shenimet shpjeguese per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 dhjetor 2021

Rezerva te tjera ne shumen 715,932,143 leke ka lidhje me rezervat e krijuara nga shoqeria nga shperndarja e fitimit sipas vendimit te ortakeve e kaluar per rezerva per investime.

Shoqeria ka shperndare divdent sipas vendimit te ortakeve ne shumen 162,129,951 leke.

## 9. DETYRIMET AFAT GJATA

Llogaria “Huat afatgjata” me vlerë 531,219,201 leke, perben detyrimin e shoqerise per huane ndaj Bankes perkatesht.

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Huar bankare nga Procredit Bank	114,261,865	248,843,303
Huar bankare nga Raiffeisen Bank	462,850,188	127,967,815
Detyrime per qera leasing	36,559,887	16,878,403
OTP Bank	<u>364,270,370</u>	<u>393,753,309</u>
	<b><u>977,942,310</u></b>	<b><u>393,753,309</u></b>

## 10. DETYRIME AFATSHKURTRA

Detyrime afatshkurtra analizohet sipas zerave ne tabelen e meposhteme :

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Furnitore	842,039,766	755,915,375
Huar bankare	313,291,146	364,150,280
Paga e punonjesve.	11,058,738	60,568,533
TAP	751,267	693,412
Tatim fitimin	44,286,798	2,467,564
Tvsh	6,077,980	11,036,447
Sigurime	3,031,797	2,537,333
Tatim ne burim	497,838	143,647
Te tjera pagueshme	204,222,931	108,973,026
Arketime ne avance	<u>70,003,213</u>	<u>135,584,498</u>
	<b><u>1,495,261,474</u></b>	<b><u>1,442,070,114</u></b>

- Detyrime nga ndaj furnitoreve ne shumen 842,039,766 leke .
- Huara bankare ne shumen 313,291,146leke perfaqeson detyrimin qe ka ndaj kredise se mare ne Procredit Bank e Raffesen Bank e Procredit bank dhe Tirana Bank
- Detyrimin ne shumen 11,058,738 leke i perket detyrimit per pagat e punonjesve te Gjate vitit kontributet jane llogaritur sakte dhe derdhur rregullisht ne tatime.
- Detyrime tatimore me vlerë 54,645,680 leke, i perket detyrimit per tatimin e mbajtur nga pagat e personelit sipas listes pageses se muajit dhjetor 2021, ne shumen 751,267 leke,dhe sigurime shoqerore ne shumen 3,031,797leke, tatim ne burim ne vleren 497,838 leke, tatim fitimi ne vleren 44,286,798 leke, e tvsh ne vleren 6,077,980 leke.
- Te tjera te pagueshme ne shumen 204,222,931 leke, i perket detyrimit ndaj ortakeve dhe te tjera detyrime.

## 11. TE ARDHURAT

Te ardhurat analizohen sipas zerave ne tabelen e meposhteme :

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Shitje mallrash	4,944,761,055	2,445,597,572
Te ardhura te tjera	32,214,308	44,003,560
Te tjera financiare	<u>4,976,975,363</u>	<u>2,489,601,132</u>

## 12. LËNDË E PARË DHE MATERIALE TË KONSUMUESHE.

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Blerje e materialeve të para	3,927,167,914	1,834,080,917
	<b>3,927,167,914</b>	<b>1,834,080,917</b>

## 13. PERSONELI

Shpenzimet per paga analizohen ne tabelen e meposhteme. Shoqeria paguan vetem sigurimet e detyrueshme shoqerore dhe shendetsore per punonjesit e saj.

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Paga	109,057,745	109,057,745
Sigurime Shoqerore dhe shendetsore	17,966,149	17,966,149
	<b>161,192,622</b>	<b>127,023,894</b>

## 14. SHPENZIME TE TJERA

Zeri shpenzime te tjera analizohet ne tabelen e meposhteme, sipas llojit te shpenzimit.

	<b>31 Dhjetor 2021</b>	<b>31 Dhjetor 2020</b>
Blerje,energji,avull,uje	41,849,619	30,391,751
Qera	7,246,158	372,800
Shërbime nga të tretët	32,936,118	0
Mirëmbajtje dhe riparime	6,758,670	
Sigurime	3,756,546	2,221,512
Të tjera	8,203,202	26,020,287
Transferime, udhëtime, dieta	42,134,309	32,623,772
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	2,310,367	1,896,437
Shpenzime për shërbimet bankare	11,606,855	3,005,420
Taksa, tarifa doganore	19,348,350	10,166,792
Taksa dhe tarifa vendore	2,762,212	7,884,948
Taksa e regjistrimit		
Tatime të tjera	1,730,500	651,844
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	7,525,498	2,688,547
shpenzime per shërbime doganore	3,319,432	1,528,783
Gjoba dhe dëmshpërblime	6,100,731	3,043,383
Vlera neto e asetit te shitur	510,735	4,151,131
	<b>198,099,301</b>	<b>126,647,406</b>

## 15. SHPENZIME INTERESI DHE TË NGJASHME

Shpenzimet e interesit dhe të ngjashme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>
Shepenzime nga Interesi	(40,484,942)	(23,581,846)
Humbje/fitim nga kembimet valutore	16,042,026	(79,985,334)

Shenimet shpjeguese per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 dhjetor 2021	(24,442,916)	(103,567,180)
---	--------------	---------------

## 16. TATIM FITIMI

Fitimi i vitit ushtrimor para tatimit për vitin 2021 eshte 527,002,133 Lekë. Rezultati para taksave është sistemuar në përputhje me ligjet fiskale në fuqi për llogaritjen e Tatim fitimit si më poshtë:

- Shpenzime per gjoba për 6,100,731 Lekë;

Si rezultat i sistemimit të mësipërm, fitimi fiskal për vitin 2021 është 533,102,864 Lekë, dhe Tatimi mbi Fitimin i llogaritur është 79,965,430 Lekë. Detyrimi per tatim fitimi, sipas deklarates vjetore prej 44,286,798 Lekë është përfshirë në postin Kërkesa te arketueshme (shënim 4). Fitimi neto eshte 447,036,703 leke.

## 17. NGJARJET PAS DATE BILANCIT KONTABEL

Drejtimi i Kompanisë aktualisht po vlerëson ndikimin e mundshëm të situatës së koronavirusit mbi operacionet e tanishme të biznesit të Kompanisë. Drejtimi i konsideron që kjo ngjarje është jo rregulluese në lidhje me pasqyrat financiare të Kompanisë, për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2021. Përveç kësaj, drejtimi konsideron që deri dhe nga data e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare, aktivitetet e kompanise dhe pozicioni finansiar mbeten materialisht të pa ndikuara nga kjo gjendje. Sidoqoftë, për shkak të pasigurisë së madhe të zhvillimit të ardhshëm të situatës së koronavirusit, brenda vendit dhe ndërkombëtarisht, nuk mund të bëhen vlerësimë të sakta të ndikimit të mundshëm në të ardhmen mbi pozicionin finanziar të Kompanisë dhe operacionet e biznesit. Drejtimi i Kompanisë i konsideron me kujdes të gjitha masat e ardhshme aktuale dhe potenciale të Qeverisë dhe është e angazhuar të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të amortizuar krizën e ardhshme të shkaktuar nga pandemia e koronavirusit, në mënyrë që të sigurojë operacionet e vazhdueshme të biznesit duke planifikuar me kujdes likuiditetin e saj dhe duke i përshtatur situata e pësuar rishtazi në ekonominë lokale dhe globale. Pas dates 31 dhjetor 2021 dhe deri në nxjerrjen e këtyre pasqyrave financiare, nuk ka ngjarje që do të ketë nevojë për shpalosje në pasqyrat financiare.

**ADMINISTRATOR**

Sokol Çupi

